



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 214, Datë 24.08.2022

MBI

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT PËR
LICENCIMIN E BURSËS SHQIPTARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SH.A.
NË VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 2 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1476 prot., datë 18.08.2022, “Mbi licencimin e BURSËS SHQIPTARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE” - ALPEX sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 183, datë 13.07.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE” - “ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.
- ERE ka bërë njoftimin në median e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 15.07.2022 dhe 16.07.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.07.2022) nuk kanë rezultuar të keishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 966/2 prot., datë 28.07.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE”- “ALPEX” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 966 prot., datë 08.08.2022, ka përcjellë dokumentacion plotësues të aplikimit, por nga i cili mbeten ende dokumeta për t’u sqaruar me shoqërinë dhe depozituar në ERE.
- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, është parashikuar se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar*

në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

- Shoqëria ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar nga rregullorja, dhe duhet të evidentohet fakti që ky aplikim bëhet për herë të parë në ERE. Po ashtu duke vlerësuar rëndësinë e veçantë që Bursa Shqiptare e Energjisë do të ketë në tregun Shqiptar dhe atë të Kosovës në zbatim të VKM-së nr. 322, datë 15.05.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e fomës ligjore dhe strukturës së ponësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut” dhe Vendimit nr. 1, datë 27.01.2021 “Për miratimin e hapjes së Degës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në Kosovë”, vlerësohet zhvillimi i një seance dëgjimore me qëllim sqarimin e dokumentacionit të aplikimit.
- Shoqëria “BURSA SHQIPTARE E ENERGISË ELEKTRIKE” - “ALPEX” sh.a. duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 10 ditëve pune nga marrja dijani e vendimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “BURSA SHQIPTARE E ENERGISË ELEKTRIKE” - “ALPEX” sh.a. për licencim në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.
2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e vendimit, shoqëria “BURSA SHQIPTARE E ENERGISË ELEKTRIKE” - “ALPEX” sh.a. duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI